



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 29 maj 2012
Nr. ref.: RK247/12

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rastin Nr. KI95/11

Parashtrues

Hajrije Behrami dhe e bija e saj (e mitur)

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjkimit të Gjykatës Supreme të Kosovës
Rev. nr. 1230/2010, të 15 shkurtit 2011**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar
Kadri Kryeziu, Zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Ivan Čukalović, gjyqtar
Gjyljeta Mushkolaj, gjyqtare dhe
Iliriana Islami, gjyqtare

Parashtrues të kërkesës

1. Parashtrues të kërkesës janë Hajrije Behrami dhe e bija e saj, e cila është e mitur, nga fshati Damanek i Komunës së Drenasit.

Objekti i çështjes

2. Objekt i çështjes së kërkesës është kërkesa nga ish e veja e një viktime civile të luftës në emër të saj dhe të fëmijës së vet të mitur, për pension sipas Ligjit për statusin dhe të drejtat e familjeve të dëshmorëve, invalidëve, veteranëve dhe pjesëtarëve të UÇK-së dhe familjeve të viktimave civile të luftës, Ligji Nr. 02/L-2.
3. Parashtrueset pretendojnë se ka pasur shkelje të neneve 21, 22, 24, 31, 37 (paragrafi 3), 50, 51 dhe 54 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta).

Baza juridike

4. Kërkesa është e bazuar në nenin 113.7 të Kushtetutës, në nenet 46, 47, 48 dhe 49 të Ligjit Nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Ligji), dhe në rregullin 56.2 të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Vendimi i kontestuar

5. Parashtrueset i kontestojnë vendimet e Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale të Kosovës në Prishtinë – Departamentit për Familjet e Dëshmorëve, Invalidëve të Luftës dhe Viktimave Civile (në tekstin e mëtejme: DFDILVC), nr. 01-03/6954, të 20 tetorit 2010, dhe nr. 01-03/6954, të 11 nëntorit 2010, dhe Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës A. nr. 1230/10, të 15 dhjetorit 2010.

Procedura në Gjykatë

6. Parashtrueset e dorëzuan kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata) më 13 korrik 2011.
7. Më 17 gusht 2011, Kryetari e caktoi gjyqtaren Gjyljeta Mushkolaj Gjyqtare raportuese dhe Kolegjin shqyrtues të përbërë nga gjyqtarët Robert Carolan, Snezhana Botusharova dhe Iliriana Islami.
8. Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin paraprak të Gjyqtares raportuese më 7 mars 2012 dhe i rekomandoi Gjykatës për papranueshmëri të kërkesës.

Përmbledhje e fakteve

9. Më 20 tetor 2010, DFDILVC, në Vendimin e vet nr. 01-03/6954, e refuzoi kërkesën e parashtrueseve për pension për familjet e viktimave civile të luftës. DFDILVC theksoi se kërkesa ishte refuzuar për shkak se parashtruesja e parë kishte lidhur martesë të re, e cila, sipas nenit 11, paragrafit 3, të Ligjit për statusin dhe të drejtat e familjeve të dëshmorëve, invalidëve, veteranëve dhe pjesëtarëve të UÇK-së dhe familjeve të viktimave civile të luftës, Ligji Nr. 02/L-2 (në tekstin e mëtejme: Ligji Nr. 02/L-2), ia mohon të drejtën për pensionin e sipërpërmendur. Parashtrueset u njoftuan se mund të paraqitnin ankesë kundër këtij vendimi në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit.
10. Më 11 nëntor 2010, sektori për ankesa i DFDILVC-së nxori vendimin e vet me të cilin e refuzonte ankesën e paraqitur nga parashtrueset. Ai gjithashtu konstatoi që parashtrueset nuk kishin të drejtë në pension pasi parashtruesja e parë kishte lidhur martesë të re.

11. Më 20 dhjetor 2010, parashtrueset parashtruan kërkesë në Gjykatën Supreme për anulimin e vendimit të 11 nëntorit 2010. Parashtrueset pohuan se vendimi i kontestuar ishte i padrejtë dhe i paligjshëm për shkak të vërtetimit të gabueshëm dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale. Parashtrueset theksuan se organi i shkallës së parë gabimisht e kishte vërtetuar gjendjen faktike me arsyetim të pabazuar se parashtruesja e parë nuk e gëzon statusin e anëtarit të familjes së viktimës civile të luftës pasi ka lidhur martesë të re.
12. Më 15 shkurt 2011, Gjykata Supreme e Kosovës, nëpërmjet Aktgjykimit A. nr. 1230/2010, e refuzoi kërkesën e parashtrueseve. Gjykata Supreme konstatoi që sektori për ankesa i DFDILVC-së e kishte vërtetuar gjendjen faktike në mënyrë të drejtë dhe të plotë me rastin e refuzimit të ankesës së parashtrueseve. Gjykata Supreme u pajtua me arsyetimin në seancën e parë dhe të dytë dëgjimore se parashtruesja e parë nuk e gëzonte statusin e anëtarit të familjes pasi kishte lidhur martesë të re.

Pretendimet e parashtrueseve

13. Parashtrueset pretendojnë se u ishte mohuar njëra prej të drejtave të tyre themelore të garantuara dhe të mbrojtura me dispozitat e nenit 21 të Kushtetutës, dhe të drejtat dhe liritë e njeriut të garantuara me marrëveshjet dhe instrumentet ndërkombëtare ligjore në përputhje me nenin 22 të Kushtetutës.
14. Parashtrueset pretendojnë që u ishte mohuar e drejta e barazisë para ligjit sipas nenit 24 dhe u ishte mohuar e drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm sipas nenit 31 të Kushtetutës.
15. Parashtrueset pohojnë që kishte shkelje të nenit 37 të Kushtetutës për shkak se shteti ua kishte mohuar mbrojtjen e posaçme që e gëzojnë familjet.
16. Parashtrueset pohojnë që u ishin mohuar të drejtat e garantuara me dispozitat e nenit 50 [E Drejta e Fëmijës] dhe nenit 51 [Mbrojtja Shëndetësore dhe Sociale] të Kushtetutës.
17. Së fundi, parashtrueset pretendojnë që, duke ua shkelur të drejtat e tyre të garantuara juridike, atyre u ishte mohuar e drejta për mjete efektive juridike sipas nenit 54 të Kushtetutës.

Vlerësimi i pranueshmërisë

18. Sa i përket kërkesës së parashtrueseve, Gjykata i referohet nenit 49 të Ligjit, i cili thotë:

“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor. Në të gjitha rastet e tjera, afati fillon të ecë në ditën kur vendimi ose akti është shpallur publikisht. Nëse kërkesa është e drejtuar kundër një ligji, atëherë afati fillon të ecë që nga dita kur ligji ka hyrë në fuqi.”
19. Nga parashtrësia mund të kuptohet që kërkesa nuk është parashtruar brenda afatit kohor të paraparë me nenin 49 të Ligjit.
20. Vendimi i dytë është Aktvendimi i Gjykatës Supreme të Kosovës Rev. nr. 1230/2010, i 15 shkurtit 2011, të cilin parashtrueset pohojnë ta kenë marrë më 10 mars 2011 përmes avokatit të tyre Cenë Gashi. Parashtrueset e dorëzuan kërkesën e tyre në Gjykatën Kushtetuese më 13 korrik 2011. Kjo do të thotë se ato e dorëzuan kërkesën e tyre jashtë afatit kohor të paraparë me nenin 49 të Ligjit.

21. Prandaj, rezulton që kërkesa është e papranueshme në përputhje me rregullin 36 (1b) të Rregullores së punës, i cili thotë: *“Gjykata mund t’i shqyrtojë kërkesat vetëm nëse: b) kërkesa parashtrohet brenda katër muajsh nga dita e dorëzimit të vendimit të mjetit të fundit juridik efektiv të parashtresës”*.
22. Edhe sikur raporti të mos ishte i papranueshëm për shkak të afatit kohor, Gjykata Kushtetuese përsërit që nuk është detyrë e saj, sipas Kushtetutës, të veprojë si gjykatë e apelit, apo gjykatë e shkallës së katërt, lidhur me vendimet e nxjerra nga gjykatat e rregullta. Është detyrë e gjykatave të rregullta t’i interpretojnë dhe zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale (*shih, mutatis mutandis, García Ruiz kundër Spanjës [DHM], nr. 30544/96, para. 28, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut [GJEDNJ] 1999-1*).
23. Gjykata Kushtetuese vetëm mund të shqyrtojë nëse provat para gjykatave dhe organeve të tjera janë paraqitur në mënyrë të drejtë dhe nëse procedurat në përgjithësi, të shikuara në tërësinë e tyre, janë mbajtur në mënyrë të tillë saqë parashtresës i kësaj kërkesë të ketë pasur gjykim të drejtë (*shih Aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese, të 23 qershorit 2010, të Korporatës Energjetike të Kosovës kundër 49 aktgjykimeve individuale të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, paragrafët 66 dhe 67*).
24. Pas shqyrtimit të procedurave të zhvilluara në gjykatat e rregullta si tërësi, Gjykata Kushtetuese nuk gjen që procedurat përkatëse ishin në ndonjë mënyrë të padrejta apo të prekura nga arbitrariteti (*shih, mutatis mutandis, Shub kundër Lituanisë, Vendimi i GJEDNJ-së për pranueshmëri të kërkesës, nr. 17064/06, i 30 qershorit 2009*).
25. Përveç kësaj, parashtreset nuk kanë dorëzuar ndonjë provë *prima facie* që tregon shkeljen e të drejtave të tyre sipas Kushtetutës (*shih Vanek kundër Republikës së Sllovakisë, Vendimi i GJEDNJ-së për pranueshmërinë e kërkesës nr. 53363/99, i 31 majit 2005*). Parashtreseve u ishin ofruar mundësi të shumta për ta paraqitur rastin e tyre dhe për ta kontestuar interpretimin e ligjit të cilin e konsiderojnë jokorrekt në DFDILVC dhe në Gjykatën Supreme. Pas shqyrtimit të procedurës në tërësi, Gjykata nuk gjeti që procedurat përkatëse ishin në ndonjë mënyrë të padrejta apo arbitrare (*shih, mutatis mutandis, Shub kundër Lituanisë, Vendimi i GJEDNJ-së për pranueshmëri të kërkesës, nr. 17064/06, i 30 qershorit 2009*).
26. Sa i përket kërkesës së parashtresës dytë, Gjykata gjen që kërkesa është e pabazuar. Gjykata arrin në përfundimin se parashtresja e dytë nuk ka të drejtë në pension familjar sepse ajo është nën përkujdesje të parashtresës së parë dhe neni 11, paragrafi 3, i Ligjit Nr. 02/L-2 u lejon pension familjar vetëm fëmijëve pa përkujdesje prindërore të viktimave civile të luftës.
27. Pasi parashtreset thjesht kontestojnë nëse Gjykata Supreme e ka zbatuar ligjin përkatës dhe nëse ka nxjerrë konkluzione të mirëfillta faktike, duket që parashtreset thjesht kërkojnë që Gjykata ta anulojë vendimin ligjor të Gjykatës Supreme. Prandaj, kjo kërkesë është qartazi e pabazuar sa i përket shkeljes së të drejtave të tyre kushtetuese apo të njeriut, dhe, si rrjedhojë, është e papranueshme.
28. Prandaj, kriteret për pranueshmëri nuk janë përmbushur në këtë kërkesë. Parashtreset kanë dështuar ta mbështesin me prova pretendimin se vendimi i kontestuar ua ka shkelur të drejtat dhe liritë e tyre kushtetuese.
29. Rezulton që kërkesa është qartazi e pabazuar në përputhje me rregullin 36 (2b) të Rregullores së punës, i cili thotë: *“Gjykata do të refuzojë një kërkesë si qartazi të pabazuar nëse bindet se: b) faktet e paraqitura në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin për shkeljen e një të drejte kushtetuese”*.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës e nenin 20 të Ligjit, dhe rregullin 56.2 të Rregullores së punës, pas këshillimit dhe votimit të mbajtur më 7 mars 2012, njëzëri:

VENDOSI


- I. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme;
- II. Ky Vendim do t'i komunikohet parashtrueses; dhe
- III. Ky Vendim do të publikohet në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit dhe hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese



Dr. Gjyljeta Mushkolaj

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese



Prof. Dr. Enver Hasani